

NJOHJA E DIPLOMAVE DHE CERTIFIKATAVE TË LËSHUARA NGA INSTITUCIONET E HUAJA TË ARSIMIT TË LARTË

PËRSHKRIMI:

Ky shërbim elektronik u vjen në ndihmë qytetarëve që aplikojnë për njësimin e certifikatave dhe diplomave të huaja të lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë, të cilat i përkasin niveleve nga 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Në kualifikimet e niveleve 5 – 8 të Kornizës së Shqiptare të Kualifikimeve përfshihen Diploma Profesionale, Bachelor, Master, Specializime Afatgjata, si dhe Doktoratë.

Pranë *Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA)*, kryhen njësimet për: Diploma Profesionale, Bachelor, Master dhe Specializime Afatgjata. Ndërsa njësimi i diplomave të nivelit 8 - Doktoratë kryhet pranë MASR.

PROCEDURAT E APLIKIMIT DHE DOKUMENTACIONI

I. *Aplikimi për njohjen dhe njësimin e kualifikimeve që i përkasin nivelit 5 deri në 8 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve kryhet vetëm online nëpërmjet portalit e-albania*, sipas procedurës sa më poshtë:

1. Aplikanti plotëson formularin e aplikimit online në portalin e-albania.
2. Aplikanti ngarkon në format elektronik (PDF) dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a. diplomën/certifikatën, ose dokumentin zyrtar përkatës në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, të noterizuar, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë, apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës;
 - b. listën e notave dhe/ose suplementin e diplomës, të noterizuar, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë, apo nga përkthyes të licencuar në vendin e origjinës;
 - c. fotokopja e kartës së identitetit ose të pasaportës (vetëm për shtetasit e huaj);
 - d. mandat-pagesa (për rastet kur aplikanti kryen pagesën nëpërmjet bankës ose zyrave të postës shqiptare. <http://qsha.gov.al/>)

II. Aplikanti, pasi ka përfunduar procedurën e aplikimit online në portalin e-albania, duhet të dërgojë *edhe në rrugë postare (format hard-copy), dokumentet e mëposhtme:*

- a. diplomën/certifikatën ose dokumentin zyrtar përkatës në vendin e origjinës ekuivalent me diplomën që vërteton përfundimin e studimeve, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë, *me përjashtim të dokumentacionit në gjuhën angleze, italiane dhe frënge, për të cilat nuk është i domosdoshëm përkthimi në gjuhën shqipe;*
- b. listën e notave ose suplementin e diplomës, të noterizuar, si dhe të përkthyer në gjuhën shqipe nga përkthyes të licencuar në Republikën e Shqipërisë, *me përjashtim*

të dokumentacionit në gjuhën angleze, italiane dhe frënge, për të cilat nuk është i domosdoshëm përkthimi në gjuhën shqipe;

Adresa postare:

**Qendra e Shërbimeve Arsimore,
Bulevardi Zhan D'Ark, Nr 23 , Tiranë.**

Në rastet e pamundësisë së kryerjes së procedurave të përkthimit në gjuhën shqipe, aplikanti mund të përkthejë dokumentin në vendin e origjinës në gjuhën angleze nga një përkthyes i autorizuar/licencuar për këtë qëllim, në vendin përkatës. Në këto raste dokumenti duhet të mbajë domosdoshmërisht vulën apostile/legalizimin lidhur me përkthimin.

Verifikimi i dokumenteve:

Spektori i Njohjes së Diplomave (SENJOD), kryen verifikimin e autenticitetit të diplomës apo certifikatës në rastet kur këto dokumente nuk janë të pajisur me Vulë Apostile/Legalizim, apo nuk janë të legalizuara në vendin e origjinës sipas përcaktimeve në këtë udhëzim, si dhe në rastet e dokumentacionit të lëshuar në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë rast Spektori kontakton me e-mail ose në rrugë postare me institucionin që ka lëshuar diplomën apo certifikatën përkatëse. Në rast se, pas gjashtë muajve, nga momenti i kërkesës së konfirmimit me rrugë postare, ende nuk ka përgjigje nga institucioni i huaj që ka lëshuar diplomën, praktika përkatëse depozitohet në arkivin e QSHA. SENJOD-i mund të kërkojë informacion të mëtejshëm që e konsideron të nevojshëm për vlerësimin objektiv për njohjen dhe njësimin e diplomës edhe në raste kur diploma dhe lista e notave/suplementi i diplomës janë të pajisura me vulë apostile.

Spektori kërkon informacion pranë qendrave të rrjetit evropian të informimit dhe njohjes së diplomave (ENIC – NARIC), mbi statusin e institucioneve të arsimit të lartë, vlefshmërinë e diplomave apo certifikatave, nivelin e tyre sipas kornizës kombëtare apo evropiane të kualifikimeve, si dhe informacion tjetër shtesë në funksion të njësimit të diplomës.

Materialet shpresore ose të printuara për të gjitha verifikimet e kryera, depozitohen në dosjen e aplikantit. Për verifikimet e kryera online ose me pin code të aplikantit, dokumentacioni i printuar firmoset nga nëpunësi që kryen verifikimet dhe depozitohet në dosjen e aplikantit.

Procedurat për marrjen e vendimit të njohjes dhe njësimit:

Komisioni i Njohjes së Diplomave vlerëson, njeh dhe njëson, në bazë të Kornizës Evropiane të Kualifikimeve, të Kornizës së Kualifikimeve të vendit të origjinës dhe të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve, sipas parimeve dhe standardeve ndërkombëtare të njohjes së kualifikimeve, përcaktuar në dokumentet, marrëveshjet dhe konventat ndërkombëtare, në të cilat përfshihet vendi ynë, duke respektuar dhe parashikimet e kuadrit ligjor shqiptar në fuqi.

Komisioni i Njohjes së Diplomave merr vendimin për njohje dhe njësim ose mund të vendosë t'ia kthejë dosjen Sektorit, për plotësime të nevojshme në dokumentacion, sipas udhëzimit përkatës. Sektori në bazë të vendimit të Komisionit përgatit vërtetimin e njohjes dhe njësimit, për çdo aplikant. Në rastet e mosnjohjes së diplomës apo certifikatës, Sektori përgatit përgjigjen përkatëse për aplikantin.

Koha e nevojshme për marrjen e shërbimit:

Procedurat për njohjen dhe njësimin e diplomave, certifikatave dhe gradave shkencore të fituara në përfundim të studimeve të kryera jashtë vendit, kur dosja e aplikimit është e plotësuar me të gjithë dokumentacionin e kërkuar në këtë udhëzim, përfundojnë, përgjithësisht, brenda **45 ditëve**.

QSHA **nuk** mban përgjegjësi **për vonesa të mëtejshme** që vijnë për shkak të mungesës së përgjigjes, ose të përgjigjes së vonuar nga ana e aplikantit për dorëzimin e dokumenteve plotësues apo për mungesën e përgjigjes/përgjigjes së vonuar të institucionit të arsimit të lartë që ka lëshuar diplomën, apo qendrës kombëtare përkatëse të rrjetit ENIC-NARIC.

Kujdes: *SENJOD fillon procedurën e njehsimit atëherë kur aplikimi juaj është i plotë. Aplikimi juaj quhet i plotë **vetëm** në rast se ju keni përfunduar aplikimin online, si dhe keni dërguar me postë dokumentacionin përkatës.*

Periudha e vlefshmërisë:

Vërtetimi është gjithmonë i vlefshëm (vetëm në Republikën e Shqipërisë) përveç rastit kur ka ankesa për ndryshim dhe kur revokohet nga Komisioni i Njohjes së diplomave.

Tarifa:

Tarifa për njohjen dhe njësimin e certifikatave dhe diplomave që i përkasin nivelit 5 deri në 8 (Diploma Profesionale, Bachelor dhe Master, si dhe Specializime Afatgjata), të kornizës shqiptare të kualifikimeve dhe kornizës evropiane të kualifikimeve, për çdo diplomë që kërkohet të njësohet, është **2 000 (dy mijë) lekë**. Nëse kandidati ka për të njësuar 2 diploma, pagesa do të jetë 2 x 2 000 lekë.

Pagesa kryhet në llogarinë bankare të QSHA-së të përcaktuar në faqen web të QSHA-së, në seksionin përkatës të njohjes së diplomave (shih Faturë për Arkëtim). Pagesa mund të kryhet pranë bankave të nivelit të dyte ose te Posta Shqiptare.

Procedura për marrjen e dokumentit të njehsimit që lëshon QSHA.

Në përfundim të procesit të njehsimit QSHA lëshon dokumentin e njehsimit / mosnjehsimit. Lista e aplikimeve të përfunduara publikohet në faqen zyrtare të QSHA, (www.qsha.gov.al). Secili nga aplikantët duhet të shohë në rubriken **“Njehsimi i Diplomave, Arsimi i Lartë”**, **Lista e diplomave të njehsuara: viti 2020**. Në rastin kur shikon se, emri i tij është publikuar në listë, atëherë drejtohet në QSHA për të marrë dokumentin.

Aplikanti në momentin e marrjes së vërtetimit duhet të ketë me vete edhe një dokument identifikimi. Ai firmos në regjistrin e QSHA për marrjen e dokumentit.